



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.111/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajqevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova IKS, paraqitur kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, Komuna e Pejës, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatëve të tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.111/2019 e datës 27.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër koalicionit AAK-PSD me seli në Prishtinë, Komuna e Pejës.

A r s y e t i m

Me datën 27.09.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 27 Shtator 2019 në orën 13:30, përballë Gjykatës Themelore në Pejë në distancë prej 40 metra nga hyrja e Gjykatës së Pejës shihet se janë vendosur posterat e koalicionit AAK-PSD, në të njëjtin objekt në të cilin janë të vendosura këto postera gjendet edhe Qendra për Punë Sociale. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me Rregullën zgjedhore Nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, përkatësisht nenit 3 pika 3.4. Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur dy fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 28.09.2019, koalicioni AAK-PSD, thekson se vendosja e posterave që cekën në ankese nuk janë të vendosur brenda hapësirave të Gjykatës Themelore në Pejë, por janë të vendosura në hapësirat e licencuara reklamuese, lejet e të cilave i ka lëshuar Kuvendi Komunal i Komunës së Pejës, po ashtu me tutje konfirmojnë se pasi që kanë pranuar njoftimin për ankese kanë kontaktuar strukturat menagjuese të fushatës, konkretisht Shtabin Zgjedhor në Pejë, të cilët kanë konfirmuar që këto hapësira janë të kontraktuara nga kompania Selmans Network shpk dhe posedojnë leje. Të njëjtit lusin PZAP-në që të marre për bazë veprimet e AAK PSD që është paraparë në Rregulloren Nr.11/2013 Neni 3 paragrafi 3.3,3.4 dhe 3.6 për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që të respektojnë ligjin në fuqi dhe Rregulloren e Kodit të Mirësjelljes. Koalicioni AAK-PSD i bëjnë lutje PZAP që ta refuzon të pabazuar këtë ankesë, dhe të njëjtit ti terhiqjet vrejttja për

abuzim me të drejtën e ankesës e paraparë me kodin zgjedhor. Përgjigjes në ankesë i kanë bashkangjitur provat siç janë fotografi nga publikimet në media të bëra nga koalicioni AAK-PSD për respektimin rigoroz të rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesë janë të pabazuar, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posterat e koalicionit AAK-PSD, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posterat janë vendosur 40 metra larg dyerve, të Gjykatës Themelore në Pejë, vlerëson se në këtë periudhë kohore këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, nëse objekti në të cilën pretendohet se është i vendosur posteri shërben si Qendër e Votimit, ku sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet, se: *“Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji”*

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet dispozita e lart cituar ligjore është 24 orë para procesit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti në të cilën pretendohet se është vendosur posteri afër tij shfrytëzohet si qendër e votimit në ditën e votimit, andaj paneli erdhi në përfundim se pretendimet e paraqitësit të ankesës, janë të paqëndrueshme dhe bazuar në arsyet e theksuar më lartë, dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.111/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuesi i Panelit
Zyhëri Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.